

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të  
Brendshëm  
Internal Audit Basics**

**B2**

Nr.

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

**Udhëzime/Instructions:**

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ  
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE  
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË  
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË  
KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test.

Data 27.01.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
<b>Total</b>	100	

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

1. Definicioni i auditimit të brendshëm nga Instituti Ndërkombëtar i Auditorëve të Brendshëm (IIA) thekson efektivitetin e cilës nga të mëposhtme?
  - A. Pohimeve të vlerës, kostos dhe përfitimeve.
  - B. Rrezikut të vetvetishëm, rrezikut të mbetur dhe rrezikut total.
  - C. Proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.
  - D. Qëllimi, natyra dhe fushëveprimi i punës.
  
2. Cila nga të mëposhtmet adreson individët që kryejnë punën e auditimit të brendshëm?
  - A. Standardet e veçorive të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).
  - B. Standardet e performancës të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).
  - C. Standardet e zbatimit të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).
  - D. Standardet e palëve të treta.
  
3. Të gjithë akterët e mëposhtëm pranojnë rezultatet e vlerësimit të programit të cilësisë së brendshme dhe të jashtme të aktivitetit të auditimit të brendshëm nga shefi ekzekutiv i auditimit, përveç:
  - A. Menaxherëve funksional.
  - B. Menaxherëve të lartë.
  - C. Bordit të drejtorëve.
  - D. Auditorëve të jashtëm.
  
4. Sipas Standardit të Planifikimit të IIA, termi “oreksi i rrezikut” nënkupton cilën nga të mëposhtmet?
  - A. Shmangia e rrezikut.
  - B. Kufizimi i rrezikut.
  - C. Pranimi i rrezikut.
  - D. Shpërndarja e rrezikut.
  
5. Hartat e sigurisë kërkohen sipas cilave nga standardet e mëposhtme të IIA?
  - A. Menaxhimi i burimeve.
  - B. Planifikimi.
  - C. Koordinimi.
  - D. Kontrolli.
  
6. Komunikimi i qartë i fushëveprimit përfshirës dhe përjashtues në vlerësimin e rrezikut të auditimit, planin e auditimit të brendshëm dhe angazhimin në auditim, mund të zvogëlojë rrezikun nga cila prej të mëposhtmeve?
  - A. Rreziku i biznesit.
  - B. Dështimi i auditimit.
  - C. Siguria e rreme (e pavërtetë) e auditimit.
  - D. Rreziku i reputacionit të auditimit.
  
7. Sipas Standardeve të IIA, cila nga të mëposhtme nuk është e përfshirë në fushëveprimin e funksionit të auditimit të brendshëm?
  - A. Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve dhe programeve.
  - B. Rishikimi i procesit të menaxhimit strategjik, vlerësimi i cilësisë së vendimmarrjes menaxheriale, si në aspektin sasior po ashtu edhe cilësor, si dhe raportimi i rezultateve tek komiteti i auditimit.
  - C. Rishikimi i mjeteve për ruajtjen e pasurive.
  - D. Pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, politikat, procedurat dhe kontratat.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

8. Kohët e fundit, një ekip i auditimit të brendshëm përfundoi auditimin e pajtueshmërisë së kompanisë me kontratën e saj të qirasë kundrejt politikës së kompanisë për blerje të automobilave. Raporti i auditimit vuri në dukje se bazat për disa vendime për marrje me qira në vend të blerjes së automobilave, nuk janë dokumentuar dhe nuk ishin të auditueshme. Raporti përmbante rekomandimin që menaxhmenti operativ të sigurojë që marrëveshjet e tilla të qirasë të mos ekzekutohen pa dokumentacionin e duhur të bazës për vendimin për marrje me qira në vend të blerjes. Auditorët e brendshëm janë të gatshëm të kryejnë punën pasuese (follow-up) për këtë raport të auditimit. Qëllimi kryesor për kryerjen e rishikimit pasues (follow-up review) është të:
- A. Sigurohet shqyrtimi në kohë i rekomandimeve të auditorit të brendshëm.
  - B. Konstatoni se është ndërmarrë veprimi i duhur për gjetjet e raportuara.
  - C. Lejoj auditorët e brendshëm të vlerësojnë efektivitetin e rekomandimeve të tyre.
  - D. Dokumentoj se çfarë po bën menaxhmenti në përgjigje të raportit të auditimit dhe të mbyll skedarin e auditimit në kohën e duhur.
9. Një auditor i brendshëm i papërvojë njoftoi auditorin senior për një variancë të konsiderueshme nga buxheti i të audituarit. Auditori senior i tha auditorit të ri të mos shqetësohej, pasi ai kishte dëgjuar se i audituari kishte pasur një ndërprerje të paautorizuar të punës që ndoshta kjo përbënte dallimin. Cila nga deklaratat e mëposhtme është më e përshtatshme?
- A. Auditori i ri duhet ta kishte hetuar çështjen plotësisht dhe të mos e shqetësojë auditorin senior.
  - B. Auditori senior ka përdorur gjykimin adekuat për të kufizuar atë që mund të kishte qenë një hetim i kotë.
  - C. Auditori senior ishte dashur të ndalojë auditimin derisa varianca të jetë plotësisht e shpjeguar.
  - D. Auditori senior ishte dashur të ndihmojë auditorin e ri në formulimin e një plani për grumbullimin e evidencave të përshtatshme.
10. Auditimi i brendshëm është unik për faktin se fushëveprimi i tij shpesh përfshin të gjitha fushat e një organizate. Si rrjedhojë, nuk është e mundur që secili auditor i brendshëm të ketë kompetencë të detajuar në të gjitha fushat që mund të auditohen. Cila nga kompetencat vijuese kërkohet nga Standardet e IIA për çdo auditor të brendshëm?
- A. Tatimet dhe ligjet, ashtu siç zbatohen për funksionimin e organizatës.
  - B. Kompetencë në parimet e kontabilitetit.
  - C. Kuptimi i parimeve të menaxhimit.
  - D. Kompetencë në sistemet kompjuterike dhe bazat e të dhënave.
11. Auditorët duhet të përcaktojnë nëse menaxhmenti ka vendosur kritere për të vlerësuar nëse qëllimet dhe objektivat janë përmbushur. Nëse auditori përcakton se kriteret e tilla janë të pamjaftueshme ose nuk ekzistojnë, cila nga veprimet e mëposhtme do të ishte e përshtatshme?
- I. Raportimi i mangësive tek niveli i duhur i menaxhmentit dhe rekomandimi i hapave të përshtatshme të veprimit.
  - II. Rekomandoj burime alternative të kriterëve tek menaxhmenti, siç janë standardet e pranueshme të industrisë.
  - III. Formulohet kritere që auditori beson se janë adekuate dhe kryen auditimin dhe raportimin në lidhje me kriteret alternative.
- A. Vetëm I.
  - B. I dhe II.
  - C. I, II dhe III.
  - D. Vetëm II.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

12. Auditorët e kuptojnë se, ndonjëherë, nuk ndërmerren veprime korigjuese edhe kur ato dakordohen nga palët e dhura. Ky fakt e shtyn një auditor të brendshëm që të:
- A. Vendosë shtrirjen e punës së nevojshme pasuese (follow-up).
  - B. Lejon që menaxhmenti të vendosë se kur duhet të kryhet puna pasuese (follow-up), pasi është përgjegjësi përfundimtare e menaxhmentit.
  - C. Vendosë të kryej punë pasuese (follow-up) vetëm nëse menaxhmenti kërkon ndihmën e auditorit.
  - D. Shkruaj një raport të auditimit për punën pasuese (follow-up) me të gjitha gjetjet dhe rëndësinë e tyre për operacionet.
13. Cila paragraf do të karakterizohej si veçoria "Kushti" i përshkruar në Standardet e IIA?
- A. PARAGRAFI 1: Departamenti i prodhimit ka pajisjet më të reja të prodhimit në dispozicion për shkak të një zjarri që kishte rënë më parë dhe kjo kërkoi të bëhej zëvendësimi i të gjitha pajisjeve.
  - B. PARAGRAFI 2: Anëtarët e departamentit të prodhimit janë plotësisht të kënaqur me teknologjinë më të avancuar gjatë një viti e gjysmë të kaluar. Si rezultat, departamenti i prodhimit është bërë lider në industrinë e efikasitetit dhe efektivitetit të prodhimit.
  - C. PARAGRAFI 3: Departamenti i prodhimit prodhon mesatarisht 25 njësi për punëtor për ndërrim (turn). Shkalla e defektit është 1%.
  - D. Paragrafi 4: Produktiviteti mesatar i industrisë është 20 njësi për punëtor për ndërrim (turn). Shkalla e defektit të industrisë është 3%.
14. Drejtori ekzekutiv i auditimit është i shqetësuar se një mashtrim i zbuluar kohët e fundit nuk ishte zbuluar gjatë kontrollit të fundit të transaksioneve të parasë së gatshme. Një rishikim i dokumenteve të punës tregoi se transaksioni mashtrues nuk ishte përfshirë në një mostër statistikore të projektuar siç duhet të transaksioneve të testuara. Cila nga të mëposhtmet vlen për këtë situatë?
- A. Për shkak se transaksionet me para të gatshme janë një fushë me rrezik të lartë, testimi i transaksioneve është dashur të bëhet 100%.
  - B. Auditori i brendshëm ka vepruar me kujdes të duhur profesional pasi që është testuar një mostër statistikore e duhur e transaksioneve materiale.
  - C. Mashtrimi nuk do të duhej të mos-zbulohet në një fushë të audituar kohët e fundit.
  - D. Kujdesi i jashtëzakonshëm është i nevojshëm në kryerjen e një auditimi të transaksioneve me para të gatshme dhe auditori duhet të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen.
15. Cila nga të mëposhtmet nuk është zakonisht një objektiv (synim) i një rishikimi të sigurimit të cilësisë? Për të përcaktuar pajtueshmërinë me:
- A. Ligjet dhe rregulloret në fuqi.
  - B. Standardet e veçorive për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.
  - C. Standardet e Performancës për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.
  - D. Qëllimet e funksionit të auditimit të brendshëm.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

16. Koordinimi i auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mund të zvogëlojë kostot e përgjithshme të auditimit. Sipas Standardeve të IIA, kush është përgjegjës për koordinimin e përpjekjeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm?
- A. Kryeshefi ekzekutiv i auditimit.
  - B. Auditori i jashtëm.
  - C. Komiteti i auditimit i bordit të drejtorëve.
  - D. Menaxhmenti.
17. Standardet e auditimit theksojnë që auditori i brendshëm mund të komunikojë rekomandimet për përmirësime. Cila nga të mëposhtmet do të ishte një justifikim i vlefshëm për mosdhënien e rekomandimeve në një raport të auditimit? Auditori:
- A. Mund të mos kuptojë gjithmonë shkaqet e vërteta të gjetjeve të raportuara.
  - B. Nuk ka kohë të mjaftueshme për të formuluar një rekomandim për shkak të presioneve të buxhetit të auditimit.
  - C. Mund të shmangë konfrontimin duke i lejuar menaxhmentit të zgjidhë problemet e veta.
  - D. Mund të humbasë pavarësinë duke u perceptuar si marrës i vendimeve operacionale.
18. Në të kaluarën, departamenti i auditimit të brendshëm të kompanisë XYZ ka projektuar dhe instaluar sisteme kompjuterike për kompaninë. Një anëtar i sapo emëruar i komitetit të auditimit ka vënë në pikëpyetje pavarësinë e departamentit të auditimit për shkak të kryerjes së këtij aktiviteti (projektimit dhe instalimit të sistemeve kompjuterike). Cila nga veprimet e mëposhtme do të kënaqte më së miri shqetësimin e komitetit lidhur me pavarësinë?
- A. Departamenti i auditimit të brendshëm duhet të vazhdojë të projektojë dhe instalojë sisteme të tjera kompjuterike përderisa stafi i auditimit të brendshëm posedon ekspertizën për ta bërë këtë.
  - B. Departamenti i auditimit të brendshëm duhet të shmanget nga projektimi dhe instalimi i sistemeve kompjuterike për organizatën në të ardhmen.
  - C. Departamenti i auditimit të brendshëm nuk duhet të caktojë auditorët e brendshëm të cilët kanë projektuar dhe instaluar sistemin e listës së pagave për të audituar fushën e pagave.
  - D. Departamenti i auditimit të brendshëm duhet të shmanget nga kryerja dhe hartimi i procedurave për çdo sistem të organizatës së tij.
19. Një auditor i brendshëm vëren se një zyrtar për llogaritë e arkëtueshme ka qasje fizike dhe kontroll të arkëtimit në para të gatshme. Auditori ka punuar me këtë zyrtar disa vite më parë dhe ka një nivel të lartë besimi tek ky person. Prandaj, auditori thekson (potencon) në letrat e punës që kontrolli mbi arkëtimet e parasë së gatshme është adekuat. A është auditori në përputhje me standardet?
- A. Po, është treguar kujdes i arsyeshëm.
  - B. Jo, nuk janë theksuar (potencuar) parregullsitë.
  - C. Jo, alarmimi ndaj kushteve ku parregullsitë kanë më shumë gjasa të ndodhin nuk është paraqitur.
  - D. Po, u morën shënime në letrat e punës.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

20. Sipas standardeve të IIA, mbikëqyrja e një angazhimi të auditimit duhet të përfshijë:
- A. Përcaktimin se dokumentet e punës së auditimit mbështesin në mënyrë adekuate mbikëqyrjen e auditimit.
  - B. Caktimin e anëtarëve të stafit në një angazhim të veçantë.
  - C. Përcaktimin e fushëveprimit të auditimit.
  - D. Vlerësimin e performancës së secilit auditor, të paktën në baza vjetore.
21. Cila nga sistemet e mëposhtme të kontrollit të menaxhimit mat performancën në aspektin e fitimit operativ minus kosto e kapitalit të investuar në pasuritë e prekshme?
- A. Sistemi i menaxhimit të librit të hapur (open-book).
  - B. Sistemi ekonomik me vlerë të shtuar.
  - C. Sistemi i kostos së bazuar në aktivitetet.
  - D. Sistemi i vlerës së shtuar të tregut.
22. Kontrolli është përshkruar si një sistem i mbyllur i përbërë nga gjashtë elemente. Identifikoni njërin nga gjashtë elementet .
- A. Vendosja e standardeve të performancës.
  - B. Sigurimi adekuat i dosjeve të të dhënave.
  - C. Miratimi i kartës së auditimit.
  - D. Themelimi i funksionit të auditimit të pavarur.
23. Cila nga kontrollet e të dhënave hyrëse (input controls) ose kontrolleve të modifikimit do të zbulonte lloje të caktuara të gabimeve brenda fushës së shumës së pagesës së një transaksioni?
- A. Numërimi i regjistrimeve.
  - B. Kontrolli echo.
  - C. Kontrollimi i shifrës.
  - D. Kontrollimi i limitit.
24. Për t'u siguruar që mallrat e pranuar janë të njëjta me ato të paraqitura në faturën e blerjes, një sistem i kompjuterizuar duhet të:
- A. Harmonizojë fushat e zgjedhura të faturës së blerjes me mallrat e pranuar.
  - B. Mbjaj në kontroll vlerën totale të stokeve.
  - C. Llogarit totalin e grumbulluar për çdo hyrje.
  - D. Përdorë kontrollin e shifrave në numrat e llogarisë.
25. Një auditor i ri është duke u informuar për llojet e ndryshme të auditimeve nga mbikëqyrësi i auditimit. Mbikëqyrësi thekson se disa fusha brenda organizatës janë më të vështira për t'u audituar, sepse kontrollet në përgjithësi nuk janë aq të përcaktuara qartë si në departamentet e tjera. Zgjidhni llojin e kontrollit që zakonisht është më i vështirë për t'u vlerësuar.
- A. Operativ.
  - B. Harduerik.
  - C. Kontabiliteti.
  - D. Siguria fizike.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

26. Sipas raportit të COSO, plani i auditimit ndryshon kur:

- I. Rreziqet ndryshojnë.
- II. Burimet e auditimit ndryshojnë.
- III. Ndryshon Bordi.
- IV. Politikat ndryshojnë.
  - A. Vetëm I.
  - B. I dhe II.
  - C. III dhe IV.
  - D. I, II, III, IV.

27. Qëllimi i kontrollit është që:

- A. Të kontrollojë sjelljen e punëtorëve.
- B. Të përcaktojë se kush është përgjegjës për një departament.
- C. Të sigurojë se objektivat e kompanisë po arrihen.
- D. Të përcaktojë nëse një operacion është një qendër kostoje apo fitimi.

28. Drejtorët e korporatave, menaxhmenti, auditorët e jashtëm dhe auditorët e brendshëm, - të gjithë luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli. Menaxhmenti i lartë është kryesisht përgjegjës për:

- A. Krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe specifikimin e një strukture të përgjithshme të kontrollit të brendshëm.
- B. Rishikimin e besueshmërisë dhe integritetit të informacionit financiar dhe mjeteve të përdorura për mbledhjen dhe raportimin e informacionit të tillë.
- C. Sigurimin se auditorët e jashtëm dhe të brendshëm monitorojnë në mënyrë adekuate mjedisin e kontrollit.
- D. Zbatimin dhe monitorimin e kontrolleve të hartuara nga bordi i drejtorëve.

29. Qëllimi kryesor i operimit të një linje të posaçme të pandërprerë (hotline) për mashttrimet brenda kompanisë është:

- A. Zvogëlon kostot totale të operimit të kompanisë.
- B. Mat se sa mirë njësitë organizative janë duke arritur qëllimet e organizatës.
- C. Krijon kanale të komunikimit për njerëzit për të raportuar keqpërdorimet e dyshuara.
- D. Përqendrohet në fushat që meritojnë vëmendje dhe vendos më pak vëmendje në zonat që funksionojnë siç është pritur.

30. Një agjent i blerjeve, bleu artikuj për përdorim personal me fondet e kompanisë. Kompania ju lejon punonjësve të caktuar të blejnë më shumë se 250 dollarë në ditë në mallra sipas kontratave të hapura. Aprovimi i blerjeve nga ana e mbikëqyrësit ishte e nevojshme, por ky informacion nuk i ishte komunikuar palës shitëse (furnitorëve). Në vend të shqyrtimit dhe autorizimit të secilës urdhër-blerje, mbikëqyrësi në mënyrë rutinore nënshkruan fletën e autorizimit në fund të muajit pa rishikuar ndonjë dokumentacion mbështetës. Meqenëse blerjet e kësaj natyre nuk ishin objekt i politikave normale të kompanisë për pranimet, punonjësi i pandershëm mori furnizimet në depon e shitësit. Të gjitha blerjet ishin për artikujt e porositur në mënyrë rutinore nga kompania. Gjatë vitit të kaluar, punonjësi grumbulloi mallra të mjaftueshme për të filluar një biznes printimi dhe fotografie. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit të kryera nga auditori i brendshëm do të ishte më efektive në zbulimin e këtij mashtrimi?

- A. Gjurmimi i çqeve të anuluar, të përzgjedhura, me ditarin e pagesave në para të gatshme dhe me faturat e palëve shitës (furnitorëve).
- B. Kryerja e analizës së trendit të furnizimeve për shpenzime printime për një periudhë dyvjeçare.
- C. Gjurmimi i çmimeve dhe sasive në faturat e palëve shitëse (furnitorëve) të përzgjedhur me urdhër-blerjet përkatëse.
- D. Rillogaritja e saktësisë së faturave të palëve shitëse (furnitorëve) të përzgjedhur, duke përfshirë zbritjet dhe taksat e shitjes.



**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

31. Menaxhmenti i Bankës dyshon se një zyrtar për kredi i bankës shpesh ka dhënë hua për kompanitë fiktive, ka arkëtuar shumat e kredisë në llogarinë personale dhe duke lënë kështu kreditë si të papaguara në kohë. Disa fakte përkatëse në lidhje me zyrtarin për kredi përfshijnë:

- Një standard i lartë jetese, i shpjeguar si rezultat i investimeve të shëndosha dhe nuk ka marrë pushime.
- Një makinë e shtrenjtë personale e fituar nëpërmjet kontakteve të biznesit.
- Faturat e benzinës dhe të riparimit të dorëzuara nga kompania e makinave e përcaktuar nga banka, që janë më të larta se mesatarja e kompanisë (shkrimet e kilometrave janë dorëzuar në baza tremujore).
- Bezdi e dukshme lidhur me pyetjet nga auditorët.

Në këtë situatë, treguesit tipik të mashtrimit të dyshuar do të përfshijnë të gjitha këto që vijojnë përveç:

- A. Mos marrja e pushimit vjetor.
- B. Duke u bërë lehtë i bezdisur lidhur me pyetjet e auditorit për kreditë e diskutueshme.
- C. Shpjegimi i një standardi të lartë jetese si rezultat i investimeve.
- D. Dorëzimi i faturave të benzinës dhe riparimit që janë më të larta se mesatarja e kompanisë.**

32. Menaxhmenti i një organizate jofitimprurëse ka monitoruar shpenzimet dhe është e shqetësuar për shkak se pagesat për disa furnitorë duket të jenë jashtëzakonisht të larta. Shumica e blerjeve bëhen përmes funksionit të blerjes, i cili organizohet rreth tre blerësve, secili me fusha të përcaktuara blerëse. Agjentët e blerjeve vendosin urdhër-blerjet dhe marrin kopje të raporteve të pranimit për të siguruar që mallrat janë pranuar. Ata i rishikojnë raportet dhe i krahasojnë ato me urdhër-blerjet dhe me miratimin e tyre për pagesë përpara se t'i regjistrojnë në llogaritë e pagueshme. Të gjitha faturat e furnitorëve dërgohen drejtpërdrejt në llogaritë e pagueshme edhe pse raportet e pranimit të parë kalojnë nëpër agjentët blerës. Organizata ka një politikë që kërkon tre oferta për të gjitha blerjet që tejkalojnë 10,000€.

Menaxhmenti ka kërkuar që auditori të hetojë mundësinë e shantazheve që i bëhen një agjenti të blerjeve. Cila nga procedurat e mëposhtme do të ishte më pak efektive në adresimin e shqetësimit të menaxhmentit?

- A. Konfirmimi i të gjitha kushteve të kontratës me furnitorët.**
- B. Analizimi, nga agjentët e blerjeve, i të gjitha rritjeve të kostos së mallrave të prokuruar nga furnitorët specifikë.
- C. Merrja e një mostre statistikore të mallrave të blera dhe krahasimi i çmimit të blerjes për mallrat me ato të burimeve të tjera të mallrave të ngjashme, siç janë kompanitë apo katalogët e tjerë.
- D. Vëzhgimi i çdo ndryshimi në mënyrën e jetesës ose në zakonet individuale të konsumit të agjentëve të përfshirë të blerjeve.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

33. Roni dhe Gjoni kishin njohur njëri-tjetrin për shumë vite. Ata ishin bërë miq të mirë që në kolegji, ku të dy diplomuan në kontabilitet. Pas diplomimit, Roni mori në mbikëqyrje biznesin e familjes nga babai i tij. Familja e tij kishte një biznes ushqimor për disa breza. Kur Gjoni kishte vështirësi në gjetjen e një pune, Roni i ofroi atij punë në dyqanin e familjes. Gjoni dëshmoi të qenit një punonjës shumë i aftë. Ndërsa Gjoni demonstroi aftësitë e tij, Roni filloi të delegonte gjithnjë e më shumë përgjegjësi ndaj tij. Pas një periudhe kohore, Gjoni po kryente të gjitha autorizimet dhe funksionet e përgjithshme të kontabilitetit për çeqet, paratë, stoqet, dokumentet, regjistrimet dhe harmonizimet e deklaratave bankare.

(I)- Gjoni u konsiderua plotësisht i besueshëm dhe trajtoi të gjitha funksionet financiare. Askush nuk e kontrollonte punën e tij. Roni vendosi të zgjerojë biznesin dhe hapi disa dyqane të reja.

(II)- Roni trajtonte gjithmonë problemet më urgjente ... profesorët e tij të kolegjit e kishin quajtur "menaxher i krizës". Gjoni e ndihmonte me problemet kur punët e tjera të tij i lejonin kohë. Ndonëse ishte i suksesshëm në punë, Gjoni kishte vështirësi me problemet financiare personale.

(III)- Në fillim, shumat që Gjoni vodhi ishin të vogla. Ai as nuk u shqetësua për të bërë bilancin e llogarive. Por Gjoni u bë lakmitar. "Sa e lehtë është të marrësh para," tha ai. Ai ndjeu se ai ishte një anëtar kritik i ekipit të biznesit, dhe se ai kontribuoi shumë më shumë në suksesin e kompanisë sesa ishte përfaqësuar nga paga e tij.

(IV)- Do të duheshin dy ose tre vetë për të më zëvendësuar, ai shpesh mendonte për vetveten. Ndërsa shumat bëheshin çdo herë e më të mëdha, ai bëri bilancin e librave.

(V)- Për shkak të këtyre aktiviteteve, Gjoni ishte në gjendje të blente një makinë të shtrenjtë dhe të mernte familjen e tij në disa udhëtime çdo vit.

(VI)- Ai gjithashtu u bashkua me një klub të shtrenjtë të vendit. Gjithsesi, gjërat ndryshonin në shtëpi. Familja e Gjonit vuri re se shpesh ai ishte argumentues dhe në raste të tjera shumë në depresion.

(VII)- Mashtrimi vazhdoi për gjashtë vjet. Çdo vit biznesi performoi gjithnjë e më keq. Në vitin e kaluar dyqanet humbën mbi 200,000 €. Banka e Ronit kërkoi një auditim. Gjoni u rrëfye kur mendoi se auditorët kishin zbuluar përvetësimet e tij.

Kur diskutohen mashtrimet, shpesh janë identifikuar presionet, mundësitë dhe racionalizimet që shkaktojnë/lejojnë një keqbërës që të kryejë mashtrimin. Gjithashtu janë studiuar simptomat e mashtrimit.

Numri (I), " Gjoni u konsiderua plotësisht i besueshëm ...," është një shembull i një:

- A. Simptome të dokumentuar.
- B. Presioni të situatës.
- C. Mundësie për të kryer mashtrimin.
- D. Simptome fizike.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

34. Xhina Morina ishte menaxhere rajonale e shitjeve për një kompani për më shumë se dhjetë vite. Gjatë kësaj kohe ajo ishte bërë mike shumë e afërt me Fredi Hotin, një menaxher i auditimit të brendshëm. Përveç që ishin fqinjë, Xhina dhe Fredi kishin interesa shumë të njëjtat dhe i përkisnin të njëjtit klub tenisi. Ata i besonin njëri-tjetrit. Fredi i kishte ndihmuar Xhinës të zgjidhte disa probleme shitjesh dhe Xhina i kishte dhënë Fredit disa informata që çuan në zbulime të rëndësishme të auditimit gjatë tri auditimeve të kaluara.

Më poshtë janë përzgjedhur të dhënat analitike nga kompania që kanë shtyrë stafin e auditimit të besojës se ka pasur një mashtrim të pasqyrave financiare. Kryerësi duket se ka falsifikuar informacionin e shitjes për dy vitet e fundit. Fredi është i shqetësuar për shkak se ai kohët e fundit ka përfunduar një auditim në këtë fushë dhe ka pranuar shpjegimin e Xhinës për dallimet në të dhënat analitike. Fredi tani është i bindur se Xhina është e përfshirë në mashtrime.

Cili kombinim i të dhënave analitike të mëposhtme ofron treguesin më të fortë të mundësisë së mashtrimit?

Periudha	Rritja e % në shitje	Qarkullimi i stoqeve	% e marzhës bruto	Ndryshimi në % në kthimin e shitjeve
Viti aktual	10%	5	54	8%
Viti paraprak	8%	4	49	6%
- 2 vite	6%	5	42	3%
- 3 vite	4%	3.5	39	2.5%
- 4 vite	5%	4	40	3%

- A. Rritja e përqindjes në shitjet dhe qarkullimi i stoqeve.
- B. Përqindja e marzhës bruto dhe ndryshimi në kthimin e shitjeve.
- C. Qarkullimi i stoqeve dhe ndryshimi në kthimin e shitjeve.
- D. Rritja në përqindje të shitjeve dhe përqindjes së marzhës bruto.

35. Menaxhmenti i një kompanie sigurimi të pronave dhe viktimave është e shqetësuar për efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të përpunimit të kërkesave. Menaxhmenti ka dy shqetësime kryesore: (1) Janë paguar disa kërkesa që nuk duhet të paguhen ose janë paguar në shuma që tejkalojnë politikën e kompanisë; dhe (2) shumë paditës nuk janë paguar në kohën e duhur. Në përgatitjen e një auditimi të kësaj fushe, auditori i brendshëm vendos të kryejë një studim paraprak për të mbledhur më shumë informacion rreth natyrës së përpunimit të kërkesave dhe problemeve të mundshme.

Cila nga procedurat vijuese do të ishte më pak efektive në mbledhjen e informacionit në lidhje me natyrën e përpunimit të kërkesave dhe problemet potenciale?

- A. Intervistimi i mbikëqyrësve në departamentin e kërkesave për të mësuar më shumë për procedurat e përdorura dhe arsyetimin e tyre si dhe për të marrë vërejtjet e tyre për natyrën dhe efikasitetin e përpunimit të kërkesave.
- B. Dërgimi i një mesazhi me postë elektronike tek i tërë personeli zyrtar që detajon problemet e pretenduara dhe të kërkojë nga ata që të përgjigjen.
- C. Intervistimi i punonjësve të zgjedhur zyrtar në departamentin e kërkesave për të gjetur më shumë rreth procedurave të përdorura dhe arsyetimin e procedurave dhe për të marrë vërejtjet e tyre për natyrën dhe efikasitetin e përpunimit.
- D. Shpërndarja e një pyetësori për të kuptuar më mirë përgjegjësitë për përpunimin e kërkesave dhe procedurat e kontrollit të përdorura.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

36. Një ekip auditimi është caktuar për të shqyrtuar sistemin e matjes së kënaqësisë së klientit që një departament i produkteve industriale e ka implementuar dy vite më parë. Ky sistem përbëhet nga zyra e departamentit të shërbimeve për klientë që realizon një anketim vjetor përmes postës. Anketa i dërgohet 100 departamenteve të blerjeve të përzgjedhura rastësisht nga të gjithë konsumatorët që kanë bërë blerje në 12 muajt e mëparshëm. Anketa është tre faqe e gjatë dhe 30 pyetjet e saj përbëhen nga një përzierje e mënyrave të përgjigjes (p.sh. disa pyetje janë të hapura, disa me zgjidhje të shumëfishta dhe të tjerat përdorin një shkallë përgjigjesh). Zyra e shërbimit për klient e dërgon anketën në shtator dhe i paraqet në mënyrë tabelare rezultatet nga pyetëtori deri më 15 tetor. Vetëm një email dërgohet. Nëse konsumatori nuk i përgjigjet pyetësorit, nuk ridërgohet edhe një herë pyetëtori si rikujtim për plotësim. Herën e fundit kur anketa u krye, 45 nga pyetësorët nuk u kthyen mbrapa.

Cila nga të mëposhtmet nuk është një avantazh i intervistave ballë për ballë kundrejt anketave përmes postës?

- A. Shkalla e përgjigjes është zakonisht më e lartë.
- B. Intervistuesit mund të rrisin kuptueshmërinë e përgjigjeve të të anketuarit ndaj pyetjeve të bëra.
- C. Dizajnerët e anketimit mund të përdorin një shumëllojshmëri më të gjerë të llojeve të pyetjeve.
- D. Ata janë më pak të shtrenjtë, pasi që shpenzimet e postës shmangen.

37. Cila nga të mëposhtmet përshkruan më së miri disavantazhin më të madh të përdorimit të një pyetëtori dhe jo të një diagrami rrjedhës (flowchart) për të vlerësuar kontrollin e brendshëm?

- A. Pyetësorët zakonisht marrin më shumë kohë për t'u përgatitur dhe janë më të pavolitshëm.
- B. Përgjigjet nuk alarmojnë (tregojnë, shënjojnë) në mënyrë efektive dobësitë e mundshme të kontrollit të brendshëm.
- C. Është e vështirë për auditorët të zhvillojnë ose të sigurojnë pyetësorë që janë të përshtatshëm për shumicën e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- D. Auditorët mund të plotësojnë pyetësorët pa i kuptuar në të vërtetë operacionet e përgjithshme të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

38. Nëse një auditor është duke marrë mostrën për të testuar pajtueshmërinë me një politikë të caktuar të kompanisë, cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ndikon në nivelin e lejuar të rrezikut të mostrimit?

- A. Përvoja dhe njohuritë e auditorit.
- B. Pasojat negative të papajtueshmërisë.
- C. Niveli i pranueshëm i rrezikut për të nxjerrë një përfundim të gabuar të auditimit.
- D. Kostoja e kryerjes së procedurave të auditimit në përzgjedhjen e mostrave.

39. Një auditor përzgjedhi një mostër të rastësishme prej 100 artikujsh nga një popullatë prej 2000 artikujsh. Totali i përgjithshëm në euro i mostrës ishte 10,000€ dhe devijimi standard ishte 10€. Nëse saktësia e arritur bazuar në këtë mostër ishte plus ose minus 4,000 euro, vlera minimale e pranueshme e popullatës do të ishte:

- A. 204,000€
- B. 196,000€
- C. 199,000€
- D. 199,800€

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

40. Një auditor po konsideron një madhësi të mostrës prej 50 për të vlerësuar shumën mesatare për faturë në një kompani të madhe kamionësh. Si do të ndikohej saktësia e rezultateve të mostrës nëse madhësia e mostrës do të rritet në 200?
- A. Mostra më e madhe do të ishte rreth dy herë më e saktë sesa mostra më e vogël.
  - B. Mostra më e madhe do të ishte rreth katër herë më e saktë sesa mostra më e vogël.
  - C. Megjithëse saktësia nuk do të rritet aq shumë, do të korrigjohej një rënie e mundshme në vlerësimin e mesatares për faturë.
  - D. Meqë të dy madhësitë e mostrës janë më të mëdha se 30, rritja nuk do të kishte shumë ndikim në saktësi.
41. Arsyeja kryesore për një auditor që të përdorë mostrat statistikore është:
- A. Siguron një mostër më të vogël se sa që do të kërkohej nga teknikat jostatistikore të mostrimit.
  - B. Siguron një mostër që është më përfaqësuese e popullatës se sa që do ta siguronte nga teknikat jostatistikore të mostrimit.
  - C. Lejon auditorin të kuantifikojë (përcaktojë sasinë) dhe kështu të kontrollojë rrezikun e marrjes së një vendimi të pasaktë bazuar në evidencën e mostrës.
  - D. Përbushë kërkesat e Standardeve të IIA.
42. Gjatë testimit të transaksioneve të listës së pagave, një auditor zbulon se katër nga një mostër statistikore prej 100 kartash kohore (listat e vijueshmërisë) të zgjedhura nuk janë nënshkruar nga mbikëqyrësi i duhur. Për të vlerësuar materialitetin ose rëndësinë e kësaj mangësie të kontrollit, auditori duhet të:
- A. Krahasojë shkallën e tolerancës së gabimit me normën e pritur të gabimit.
  - B. Llogarit një kufi më të lartë të saktësisë dhe të krahasojë atë me gabimin e tolerueshëm.
  - C. Vlerësojë shumën në euro të katër kartave të kohës (listave të vijueshmërisë) në lidhje me pasqyrat financiare.
  - D. Raportoje gabimet dhe të lejoj menaxhmentin të vlerësojë rëndësinë, sepse ata janë në pozitën më të mirë për ta ditur.
43. Një auditor i brendshëm dyshon se faturat nga një numër i vogël i furnitorëve përmbajnë gabime serioze dhe për këtë arsye kufizon mostrën vetëm për ata furnitorë. Disavantazhi kryesor i zgjedhjes së një mostre të tillë të artikujve për t'u shqyrtuar është:
- A. Vështirësia e sigurimit të artikujve të mostrës.
  - B. Pamundësia për të kuantifikuar gabimin e mostrimit në lidhje me popullatën e përgjithshme të faturave nga furnitorët.
  - C. Mungesa e një shpërndarje normale.
  - D. Tendenca për të mostruar një numër më të madh të njësive.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

44. Auditori i brendshëm përdor një numër teknikash për të zgjedhur mostrat. Një teknikë e përdorur shpesh dhe e përshtatshme, është përzgjedhja e rastësishme. Në cilën nga situatat e mëposhtme do të ishte përzgjedhja e rastësishme më pak e justifikuar? Auditorit i duhet të:
- A. Testoj transaksionet e shitjes për të përcaktuar se ato ishin të autorizuar siç duhet dhe mbështeten nga dokumentet e transportit.
  - B. Konfirmoj llogaritë e arkëtueshme dhe tashmë ka zgjedhur 10 llogaritë më të mëdha për konfirmim. Llogaritë e mbetura nuk numërohen. Auditori ka vetëm një listë kompjuterike të llogarive në mënyrë alfabetike të gjatë rreth 250 faqe me 50 saldo të llogarive në çdo faqe.
  - C. Siguroj prova për ndërprerjen (cutoff) e duhur të shitjes duke marrë mostra nga ditarët e shitjeve mujore për të përcaktuar nëse artikujt janë regjistruar në periudhën e duhur kohore.
  - D. Testoj regjistrimet e stokeve të përhershme për të siguruar që mostra mbulon vlerat më të mëdha të aritkujve në euro në llogari.
45. Një mostër nga një popullatë prej mbi 10,000 faturash të ngarkimit është e nevojshme për të vlerësuar një shkallë gabimi. Meqenëse një madhësi e mostrës prej 250 do të kënaq nevojat e saktësisë dhe nivelit të besimit, është zgjedhur një interval mostrimi prej 40. Për lehtësinë e zbatimit, auditori zgjedh rastësisht një numër midis 1 dhe 40 dhe pastaj zgjedh çdo të 40-in artikull pasues. Cila nga të mëposhtmet është e vërtetë?
- A. Mostrës i mungon rastësia dhe nuk do të jetë e saktë.
  - B. Mostrat e intervaleve nuk janë një metodë e pranueshme statistikore.
  - C. Nëse popullatës i mungon anësia (nuk anon nga një njësi e caktuar apo vlerë e caktuar), mostra është statistiki dhe vlefshme.
  - D. Mostra e intervaleve eliminon përdorimin e gjykimit të auditorit.
46. Një auditor dëshiron të përcaktojë nëse shkalla e gabimit në kërkesat e rimbursimit për udhëtime është brenda nivelit të tolerancës prej 5% të përcaktuar nga menaxhmenti. Cilin plan të përzgjedhjes së mostrës duhet të përdorë auditori?
- A. Përzgjedhja e mostrave sipas variablave (ndryshoreve).
  - B. Përzgjedhja e mostrave sipas veçorive.
  - C. Përzgjedhja e mostrave duke u bazuar në gjykim.
  - D. Përzgjedhja e mostrave në njësi euro.
47. Një auditor po teston mbi një kartelë të madhe të llogarive të arkëtueshme të një kompanie. Objektivat e auditimit janë të testojnë saldot në euro në fund të periudhës dhe normat e përjashtimit (gabimit) të regjistrimeve të të arkëtueshmeve. Konto e llogarive të arkëtueshme përmban një numër të madh të saldove të shumave të vogla në euro dhe një numër të vogël të saldove në shuma të mëdha në euro dhe auditori pret të gjejë gabime të shumta në saldot e llogarive. Teknika më e përshtatshme e përzgjedhjes së mostrave për të vlerësuar sasinë e gabimeve në euro do të ishte:
- A. Diferenca ose vlerësimi i koeficientëve.
  - B. Diferenca e pabazuar për njësi.
  - C. Probabiliteti proporcional me madhësinë.
  - D. Veçoria.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** Nga 2 pikë secila

48. Në një aplikacion të mostrimit sipas variablave (ndryshoreve), cili nga faktorët e mëposhtëm do të ndryshojë drejtpërdrejtë me një ndryshim në nivelin e besueshmërisë nga 90% në 95%?

- A. Gabimi standard i mesatares.
- B. Gabim i mos-mostrimit.
- C. Precizioni (përpikëria) i arritur.
- D. Vlerësimi i pikës së mesatares aritmetike.

49. Duke përdorur përzgjedhjen e mesatares së mostrës për njësi për të vlerësuar vlerën e stokeve, një auditor kishte rezultatet e mëposhtme:

Vlera e parashikuar e stokeve	Niveli i besueshmërisë	Intervali i besueshmërisë	Gabimi standard (Devijimi standard / $\sqrt{\text{Madhësia e mostrës}}$ )	Vlera Z (përafërsisht)	Saktësia
3,000,000 €	95%	2,800,000 € – 3,200,000 €	100,000 €	2.0	200,000€

Vlera e regjistruar e stokeve ishte 3,075,000€. Gabimi standard prej 100,000€ reflekton në:

- A. Gabimin e parashikuar të popullatës bazuar në gabimet në mostër.
- B. Shkalla mesatare e gabimit në mostër.
- C. Shkalla e ndryshueshmërisë në shumën në euro të artikujve mostër.
- D. Gabimi i popullatës që auditori mund të pranojë.

50. Një auditim i inventarit të një kompanie që bën shitje me shumicë është kryer për të vlerësuar vlerën e saj. Inventari përmbante 20,000 artikuj me një vlerë në libra prej 1 milion euro. Plani i auditimit ishte të vlerësonte vlerën e inventarit me një saktësi prej  $\pm 2\%$  në një nivel besueshmërie prej 90%. Rezultatet e mostrës ishin:

Madhësia e mostrës: 300  
 Mesatarja e mostrës për njësi: 52€  
 Devijimi standard i mostrës për njësi: 10.80€  
 Saktësia e mostrës për njësi: 1.03€

Bazuar në rezultatet e mostrës, vlera e vlerësuar e inventarit është ndërmjet:

- A. 784,000 € dhe 1,216,000€
- B. 844,000 € dhe 1,256,000€
- C. 1,019,400 € dhe 1,060,600€
- D. 979,400 € dhe 1,020,600€